

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.07.2024*

**24.07.2024
Ora 16:00**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, z. Erion Meta.
- **Parti Politike:** S’ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë, në seancë kemi dy çështje në rend dite të cilat lidhen me përgatitjen e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

- Projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024” dhe,

- Projektvendimin që ka të bëjë me “Delegimin e kompetencës së KZAZ-së, nr. 88, Bashkia Himarë, për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të partive politike”. Po, vazhdojmë me pikën e parë, Erion!

Z. E. Meta: Përshëndetje! Projektvendimi mbështetet në nenet 19, 95, 96 të “Kodit Zgjedhor” si dhe udhëzimin 5, datë 16.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.07.2024*

Zgjedhjeve. Këto dispozita përcaktojnë procedurën si dhe kriteret për caktimin e partive politike, që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupit të Numërimit të Votave, përmes hedhjes së shortit në seancë publike. Qëllimi i projektvendimit është caktimi i anëtarit të tretë dhe të katërt të Grupit të Numërimit, për zgjedhjet e pjesshme për Bashkinë Himarë, të datës 4 gusht 2024. Për caktimin e partive që propozojnë anëtarët e tretë dhe të katërt, Komisioneri mbështetet në përcaktimet e “Kodit Zgjedhor”, konkretisht neni 95, pika 2, anëtari i tretë propozohet nga shumica parlamentare dhe anëtari i katërt nga opozita. Neni 96, pika 1, përcakton se partitë që kanë të drejtën të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt, caktohen pas hedhjes së shortit, bazuar në listat e partive të shumicës dhe opozitës parlamentare që kanë fituar të paktën dy mandate në zgjedhjet e mëparshme në Kuvendin e Shqipërisë. Në bazë të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë dhe listës së partive të regjistruara për zgjedhjet e pjesshme në Bashkinë Himarë, rezulton se: Partia Socialiste e Shqipërisë ka të drejtën të propozojë anëtarin e tretë, Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë janë parti të pakicës parlamentare. Partia Demokratike nuk plotëson kushtet për të propozuar anëtarin e katërt, pasi ka propozuar kryetarin e KZAZ-së. Në këtë rast e drejta e propozimit të anëtarit të katërt i kalon Partisë së Lirisë, e cila plotëson kriteret ligjore për të propozuar anëtarin e katërt të Grupit të Numërimit të Votave. Bashkëlidhur projektvendimi për shqyrtim dhe miratim.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord.

Vendimi nr. 123

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.07.2024*

**24.07.2024
Ora 16:02**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për delegimin e kompetencës së KZAZ-së, nr. 88, Bashkia Himarë, për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të partive politike”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Znj. M. Koja, z. Erion Meta.

Parti Politike: S’ka prezent

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Atëherë, lidhur me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. E. Meta: Vendimi numër 23, datë 1.02.2023, i Komisionerit përcakton procedurat dhe kriteret për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, Komisionet e Qendrave të Votimit dhe Vendin e Numërimit të Votave. Ky vendim parashikon që Komisioneri delegon KZAZ-së kompetencën për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore. Delegimi i kompetencave nga KQZ-ja te KZAZ-ja është një praktikë tashmë e konsoliduar. Ky proces ndihmon në rritjen e efikasitetit, shpejtësisë dhe transparencës si dhe përmirësimin e burimeve lokale. Për sa më sipër, në projektvendim parashikohet që KQZ-ja ia delegon kompetencat KZAZ-së nr. 88 për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore për KZAZ-në, KQV-të, GNV-në sipas afateve të përcaktuara në pikën 12, vendimi 3 të Kolegjit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.07.2024*

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord edhe me këtë projektvendim, sipas draftit të paraqitur.
Çështje të tjera kemi? Nuk kemi. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

Vendimi nr. 122

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

